



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:021037  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05522221

Ac.nr.9826/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Sh.G-K nga fshati B....., Komuna e R....., B.D-Z dhe A.V që të dyja nga R....., V.G nga fshati X....., Komuna e R..... dhe S.D nga R....., të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar A.M, avokat nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B.O, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtës) dhe shpenzimeve të transportit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.696/2019 të datës 26.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.696/2019 të datës 26.05.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.696/2019 të datës 26.05.2021, ka vendosur si në vijim: “*APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve SH.G-K, B.D-K, A.V, V.G dhe S.D si dhe*

*DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t’u paguaj kompensim për shpenzimet e udhëtimit prej 70 % nga vlera e paguar si dhe kompensim*

*në emër të ushqimit gjatë punës duke filluar prej datës 18.04.2017 e deri me datën 28.04.2021, në lartësi prej 2,00 € për një ditë pune, si vijon:*

*-Paditëses së parë Sh.G-K, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacion B..... – P..... dhe anasjelltas në vlerë prej 2,00 € ti paguaj shumën prej 918,40 € (70% i 2,00 € = 1.40 € x 656 ditë pune = 918,40 €), si dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 656 ditë në lartësi prej 2,00 € për një ditë pune shumën prej 1.312,00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2.230,40€.*

*-Paditëses së dytë B.D-Z, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacion R..... – P..... dhe anasjelltas në vlerë prej 2,00 € ti paguaj shumën prej 918,40 € (70% i 2,00 € = 1.40 € x 656 ditë pune = 918,40 €), si dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 656 ditë në lartësi prej 2,00 € për një ditë pune shumën prej 1.312,00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2.230,40€.*

*-Paditëses së tretë A.V, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacion R..... – P..... dhe anasjelltas në vlerë prej 2,00 € ti paguaj shumën prej 918,40 € (70% i 2,00 € = 1.40 € x 656 ditë pune = 918,40 €), si dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 656 ditë në lartësi prej 2,00 € për një ditë pune shumën prej 1.312,00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2.230,40 €.*

*-Paditësit së katërt V.G, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacion X..... – P..... dhe anasjelltas në vlerë prej 2,00 € ti paguaj shumën prej 918,40 € (70% i 2,00 € = 1.40 € x 656 ditë pune = 918,40 €), si dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 656 ditë në lartësi prej 2,00 € për një ditë pune shumën prej 1.312,00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2.230,40 €.*

*-Paditësit së pestë S.D, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacion R..... – P..... dhe anasjelltas në vlerë prej 2,00 € ti paguaj shumën prej 918,40 € (70% i 2,00 € = 1.40 € x 656 ditë pune = 918,40 €), si dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për gjithsejtë 656 ditë në lartësi prej 2,00 € për një ditë pune shumën prej 1.312,00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2.230,40 €, si dhe shumën e përgjithshme për të gjithë paditësit gjithsejtë prej 11.152,00 €, me kamatë ligjore prej 8% , duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë, respektivisht prej datës 31.12.2019 e deri në pagesën definitive, duke i bartur mjetet në xhirollogaritë rrjedhëse të paditësve, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim, SI ME BAZË.*

*DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 2.784,20 € me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm”.*

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të aprovohet dhe çështjen ta kthejë në rigjykim apo rivendosje apo duke ndryshuar kërkesëpadinë e paditësve duke refuzuar të njëjtën.

Përgjigje në ankesë kanë paraqitur pala paditëse përmes të autorizuarit të tyre duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës me propozim që e njëjtë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësit, nëpërmjet të autorizuarit të tyre, në gjykatën e shkallës së parë me datë 31.12.2019, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa me datën 17.05.2021 paditësit përmes parashtrësës kanë bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar më decidivisht si në propozimin të petitumit të kërkesëpadisë së precizuar si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve, precizimit të saj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.527/20, të datës 03.02.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se i ka vlerësuar deklaratimet dhe në bazë të provave të administruara, ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar, ku me kontratën e punës për mësimdhënësen Sh.G-K me nr. të prot. .... e datës 01.09.2015, është vërtetuar fakti relevant se paditësja Sh.G-K ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “.....” në ..... Nga vërtetimi mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr..... e datës 28.04.2021 është vërtetuar se paditësja Sh.G-K ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me vërtetimin e lëshuar nga SHATP, vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin X..... – F.....– P....., kushton 2,00 € për dy drejtime. Nga kontrata e punës për mësimdhënësen B.D-Z me nr. të prot..... të datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin relevant se paditësja B.D-Z ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “.....” në P..... Me vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr.1074/1 e datës 28.04.2021 është vërtetuar se paditësja B.D-Z ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me vërtetimin e lëshuar nga SHATP, është vërtetuar se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin R..... – P....., kushton 2,00 € për dy drejtime. Nga kontrata e punës për paditësen A.V me nr. të prot. 1/828 të datës 01.09.2016, gjykata ka vërtetuar faktin relevant se e njëjta ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “.....” në P..... Me vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr.....e datës 28.04.2021 vërtetohet se paditësja A.V ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me shikimin në vërtetimin e lëshuar nga SHATP, vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin R..... – P....., kushton 2,00 € për dy drejtime. Nga kontrata e punës për paditësin V.G me nr. të prot..... të datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin relevant se i njëjti ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës në SHFMU “.....” në P..... Me

vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. .... e datës 28.04.2021 është vërtetuar se paditësi V.G ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me shikimin në vërtetimin e lëshuar nga SHATP, vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin X..... – F....., kushton 1,00 € për dy drejtime dhe në relacionin F..... –P..... kushton, 1,00 € në dy drejtime. Nga kontrata e punës për paditësin S.D me nr. të prot..... të datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi S.D ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës në SHFMU “.....” në P..... Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 1078/1 i datës 28.04.2021 vërtetohet se paditësi S.D ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me shikimin në vërtetimin e lëshuar nga Kompania “.....” vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin R..... – P....., kushton 1,00 € për një drejtim.

Sa i përket vlerësimit të themelësisë së kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave nga neni 35 par.5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, të dt.18.04.2017, me arsyetim se nga provat e administruara dhe referuar dispozitave të lartcekura rrjedh se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar. Vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitën e nenit 382 të LMD-së ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, se dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyet dhe faktet vendimtare të theksuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto pretendime janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me kontratën e punës për mësimdhënësen Sh.G-K me nr. të prot..... e datës 01.09.2015, është vërtetuar fakti relevant se paditësja Sh.G-K ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “.....” në P..... Nga vërtetimi mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr..... e datës 28.04.2021 është vërtetuar se paditësja Sh.G-K ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me vërtetimin e lëshuar nga SHATP, vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin X..... – F..... – P....., kushton 2,00 € për dy drejtime. Nga kontrata e punës për mësimdhënësen B.D-Z me nr. të prot.

..... të datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin relevant se paditësja B.D-Z ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “.....” në P..... Me vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr.1074/1 e datës 28.04.2021 është vërtetuar se paditësja B.D-Z ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me vërtetimin e lëshuar nga SHATP, është vërtetuar se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin R..... – P....., kushton 2,00 € për dy drejtime. Nga kontrata e punës për paditësen A.V me nr. të prot. .... të datës 01.09.2016, gjykata ka vërtetuar faktin relevant se e njëjta ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “.....” në P..... Me vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr..... e datës 28.04.2021 vërtetohet se paditësja A.V ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me shikimin në vërtetimin e lëshuar nga SHATP, vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin R..... – P....., kushton 2,00 € për dy drejtime. Nga kontrata e punës për paditësin V.G me nr. të prot..... të datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin relevant se i njëjti ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës në SHFMU “.....” në P..... Me vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr. 1079/1 e datës 28.04.2021 është vërtetuar se paditësi V.G ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me shikimin në vërtetimin e lëshuar nga SHATP, vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin X..... – F....., kushton 1,00 € për dy drejtime dhe në relacionin F..... –P..... kushton, 1,00 € në dy drejtime. Nga kontrata e punës për paditësin S.D me nr. të prot..... të datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi S.D ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës në SHFMU “.....” në P..... Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr..... i datës 28.04.2021 vërtetohet se paditësi S.D ka përvojë të përgjithshme pune në kohëzgjatje prej gjithsejtë 656 ditë pune. Me shikimin në vërtetimin e lëshuar nga Kompania “.....” vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin R..... – P....., kushton 1,00 € për një drejtim.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në*

*institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”. Në paragrafin 5 të kësaj Kontrate përcaktohet se: “Punonjësit të kësaj Kontrate përcaktohet se arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes së të drejtës për parashtrim të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë si dhe shpenzimeve të udhëtimit, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë së paditësve.*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësve për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë dhe për shpenzime të udhëtimit, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim ushqimit dhe kompensimin e udhëtimit për ditët e pranisë në punë i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Vendimi mbi kamatën është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së pasi

që veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË**

Ac.nr.9826/2021, me datë 28.03.2023

Kryetarja e kolegjit  
Nora Bllaca-Dula d.v.